



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile

**Formulari për Nominime për
përfaqësues të shoqërisë civile**

INFORMATA PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT PËR NOMINIM

Përfaqësuesit e shoqërisë civile në Këshillin për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile do të nominohen dhe zgjedhen nga vet organizatat e shoqërisë civile, ndërsa i gjithë procesi do të organizohet nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyren për Qeverisje të Mirë të Zyres së Kryeministrit (ZQM/ZKM). Shoqëria civile përfaqësohet në Këshill me 15 përfaqësues, nga të cilët 1 emërohet nga Platforma CiviKos ndërsa 14 të tjerë zgjedhen nga vet organizatat e shoqërisë civile.

Formulari për Nominim përmban 3 pjesë:

Pjesa I: Të dhëna të përgjithshme

Pjesa II: Të dhëna mbi kandidatin/en

Pjesa III: Të dhëna mbi OShCnë që bën nominimin

Për t'u shqyrtuar, Formulari për Nominim duhet t'i përmbajë të gjitha të dhënat e kërkuara, të paraqitura në mënyrë të qartë, në mënyrë elektronike. Përveç Formularit për Nominim, aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten edhe:

1. Një biografi e kandidatit/es të nominuar;
2. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OShCsë që e bën nominimin ose dëshmia e ekzistencës së rrjetit të OShC-ve;

Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve të kompletuara është më 25 gusht 2014.

Mënyra e dorëzimit:

Të gjitha dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen - drejtëpërdrejtë ose me postë - në një zarf të mbyllur, me shënimin: "Nominim nga shoqëria civile për Këshillin për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile", në adresën:

Platforma CiviKos, Rr. Fazli Grajqevci 4/a, 10000 Prishtinë

KRITERET BAZË PËR PROCESIN E NOMINIMIT

OshC-të të cilat bëjnë nominime dhe kandidatët e nominuar duhet të plotësojnë kriteret bazë, si në vijim:

Kriteret për organizatat që nominojnë kandidatë

Të drejtë për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OShC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ si dhe rrjetet e OShC-ve pavarësisht regjistrimit të tyre, të cilat:

1. Janë aktive për të paktën 3 vite;
2. Punën e tyre të deritashme e kanë në përputhje me misionin dhe fushën përkatëse të veprimtarisë;

Kriteret për kandidatët e nominuar

Të nominuarit duhet të plotësojë këto kriteret:

1. Të kenë përvojë të dëshmuar në fushën përkatëse për të paktën 3 vite;
2. Të jenë të angazhuar në një organizatë të shoqërisë civile e cila për të paktën 3 vite të fundit ka fushë të veçantë të veprimtarisë fushën përkatëse.

Kufizimet në procesin e nominimeve

1. Secila OShC mund të nominojë vetëm një kandidat/e.
2. Secila OShC mund të nominojë përfaqësues/e nga vet ajo OShC.

Procesi i përzgjedhjes dhe votimit

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i ZQM/ZKM do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, Platforma CiviKos do të njoftojë publikisht për hapjen e procesit të votimit dhe do të publikojë në faqen e vet të internetit fletëvotimin zyrtar. Të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Secila organizatë mund të votojë për 14 kandidatë nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim.

Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platformës CiviKos do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. 14 kandidatët që marrin më së shumti vota zgjedhen si përfaqësues të OShC-ve në Këshill. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve në Këshill do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhguesëve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe përfaqësuesit e ZQM/ZKM.

Kriteret për organizatat që votojnë për kandidatët e nominuar

Të drejtë për të votuar për kandidatët e nominuar kanë të gjitha OShC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ, të cilat posedojnë Certifikatë të Regjistrimit të OJQ-së.

Mandati i përfaqësuesëve të shoqërisë civile

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të përzgjedhur si anëtarë të Këshillit për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile zgjedhen në mandat 2 vjeçar.

Para këtij afati, mandati ndërpritet në rastet e mëposhtme:

1. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në Këshill jep dorëheqje;
2. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile në Këshill largohet nga sektori i shoqërisë civile;
3. Kur të paktën 51% të organizatave të cilat kanë marrë pjesë në procesin e votimit kërkojnë nga Kryesuesi i Këshillit që të nisë procedurën e shkarkimit, për shkak të neglizhencës apo mos-përfaqësimit të duhur të interesave të shoqërisë civile në punën e Këshillit;
4. Kur përfaqësuesi/ja i shoqërisë civile nuk merr pjesë në 2 takime të njëpasnjëshme të Këshillit, pa arsye.

PJESA I - TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri dhe mbiemri i kandidatit/es:	
Datëlindja:	
Adresa:	
Tel:	
Email:	
Pozita në organizatë:	
Emri dhe shkurtesa e organizatës ku punon kandidati/ja:	
Fusha e veprimtarisë e organizatës ku punon kandidati/ja:	
Fusha e ekspertizës së kandidatit/es (nëse është e ndryshme nga ajo e organizatës):	

Të dhënat mbi organizatën që bën nominimin

Emri i OShCsë që bën nominimin:	
Adresa:	
Tel:	
Email:	
Emri i përfaqësuesit të autorizuar të OSHCsë:	
Nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar të OSHCsë:	
Data e dorëzimit të Formularit për Nominim: (plotësohet nga CiviKos)	

PJESA II - TË DHËNAT MBI KANDIDATIN/EN

Përgatitja shkollore e kandidatit/es:	
Përshkrimi i përgjegjësive të kandidatit/es në organizatë:	
Përshkrim i përfshirjes së kandidatit/es në nisma formale dhe jo-formale të institucioneve dhe/apo organizatave vendore dhe ndërkombëtare, në fushën e caktuar të veprimtarisë:	
Kohëzgjatja e angazhimit të kandidatit/es në organizatë:	
Përshkrim i përvojës së kandidatit/es në organizata/institucione tjera, në fushën e caktuar të veprimtarisë/ ekspertizës:	
Referenca të dobishme që e dëshmojnë angazhimin e kandidatit/es në fushën e caktuar të veprimtarisë/ ekspertizës:	
Informata tjera me rëndësi rreth kandidatit/es:	

Fushat e veprimtarisë së organizatës ku punon kandidati/ja:

Përshkruani shkurt misionin e organizatës ku punon kandidati/ja dhe disa aktivitete të organizatës gjatë 3 viteve të fundit që e dëshmojnë se puna e deritashme është në përputhje me misionin:

--

PJESA III - TË DHËNA MBI OShC-NË QË BËN NOMINIMIN

Misioni dhe fusha e veprimtarisë e OshCsë:	
Përshkrimi i aktiviteteve dhe arritjeve kryesore të OShCsë, në fushën e caktuar:	
Referenca të dobishme që e dëshmojnë angazhimin e OShCsë në fushën e caktuar:	
Informata tjera me rëndësi rreth organizatës:	